

## FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Detyrimi i të gjithëve që jemi deputetë është t'ju japim informacion dhe t'ju saktësojmë çfarë po ndodh në këtë parlament. Ajo që po ndodh në parlament, nuk është gjë tjetër veçse një vjedhje masive e pasurisë suaj, e pasurisë së qytetarëve të Durrësit, e pasurisë së qytetarëve shqiptarë. E gjitha kjo po ndodh, e dëgjuat, në një fjalim 54 minuta të Kryeministrit, 54 minuta për 2,1 miliardë; 54 minuta nga koha juaj për 2,1 miliardë për xhepin e tij. Kaq e thjeshtë është e gjitha. E bëri këtë me një fjalim për të ngritur peshë patriotizmin në zemrat e shqiptarëve, për të mirat e mëdha që po u bën shqiptarëve. I njëjti fjalim si ai për inceneratorët; e njëjta gjë; i njëjti përбетim; i njëjti patos.

Sot, pas kaq vitesh të inceneratorëve, ajo që mund të numërohet, është sa deputetë, ish-ministra, administratë janë sot mbrapa hekurave. Ajo që ndodh sot, nuk është gjë tjetër veçse një skenë e parë që do t'i paraprijë numrit të deputetëve, të ministrave, të administratës, të negociatorëve që janë mishi për top për të shkuar mbrapa hekurave. Kaq e thjeshtë është. I vetmi që ruhet në këtë rast, është ai që mblodhi plaçkën dhe iku. Asnjë firmë nuk ka hedhur. Unë besoj se këtu është detyrim ynë, i gjithsecilit që, pasi të bjerë entuziazmi i patriotizmit të Kryeministrit për të mirën e madhe që po u bën shqiptarëve, të kuptojmë qartë se ç'po ndodh. Gjuha e fakteve është gjuha më e thjeshtë dhe e drejtë, e cila duhet të shkojë në veshin e çdo shqiptari të Durrësit, të Shqipërisë apo edhe rajonit.

Pyetje të thjeshta janë: pse nuk ka garë? Ky Alabaar-i i famshëm, i cili paska marrë gamilet e veta nga Lindja e Mesme plot me verdhushka, që na paska ardhur në Shqipëri mes Durrësit, pse nuk ka garë? A nuk duhej të ishte një sjellje që të mbronte interesin e shqiptarëve dhe të pasurisë së shqiptarëve duke thënë: "Po, mirë se erdhe nga Lindja e Mesme, por unë duhet të bëj garë për të parë nëse ka edhe të tjerë njerëz kaq të famshëm, që e dashkan kaq shumë Shqipërinë; për të parë nëse ka një ofertë aq apo më të mirë sesa aq"? Ky është minimumi i arsyes njerëzore për të mbrojtur pronën e vet. Nëse nuk ke bërë këtë, nuk ke bërë gjë tjetër, përveçse e ke përdorur dhe e ke konstatuar. Porti i Durrësit nuk është gjë tjetër, veçse është mall pa zot; mall i tët'eti, kështu thuhet nga anët tona. Kur nuk ke gjak e djersë për pronën tënde, e shet, e fal, e shpërdoron. Këtë bën ky. Kjo është pronë e të gjithë shqiptarëve.

Do të ishte minimumi jo thjesht dhe vetëm si një sjellje njerëzore, sjellje ekonomike, dashuri patriotike për vendin, por është dhe detyrim; është detyrim kushtetues, është detyrim edhe me Kushtetutën që ka ky vend lidhur me Europën, me Perëndimin, me ata që do t'i presë më 6 dhjetor (mos e harroni), me ata, për të cilët u përbetua një javë më parë teksa thoshte se sa hapa para ka bërë Shqipëria nën drejtimin e tij, me velat drejtuar nga Perëndimi. E, pra, ky është rasti. Është detyrim nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, një marrëveshje e nënshkruar nga ky vend, e cila na detyron të gjithë ta respektojmë për të bërë një gjë të thjeshtë: garë për t'ia rritur vlerën, nëse është rasti, për të marrë maksimumin e parasë që ka aq shumë nevojë ky vend.

Po, ky vend ka nevojë për para; ka nevojë për financime ky vend. 9 vjet, pasi mbretëron ky, ka nevojë dhe është pasojë e qeverisjes së tij që në këtë vend nuk vjen kurrë asnjë investitor, i cili të sjellë emrin, të sjellë financat, të sjellë reputacionin, të bëhet vitrinë e mirë për të tërhequr biznesin e ndershëm në të mirë të shqiptarëve. Këtu ka vetëm biznesmenë, të cilëve u thyhen këmbët e largohen me dhunë; ka biznesmenë që qëmtohen te Nusreti. Pyetja që kam: çfarë qenka ky biznesmen, avokatin e cilit po bën ti, që na vjen këtu për sadaka? Në fakt, duhet të bëje avokatin e pasurisë së shqiptarëve. Si ka mundësi që ai harxhon 160 milionë apo 80 milionë dhe ti i fal, jo pak, por 730 milionë euro nga pasuria e shqiptarëve? Pra, janë 818 mijë metra katrorë në zëmër të Shqipërisë; ia kafshon këtë pjesë të truallit Shqipërisë dhe e fal për sadaka.

Vetëm vlera e truallit është 400 milionë euro. Çfarë është ky njeri kaq i pasur (në fakt, mund të jetë vërtet) që paska nevojë t'i falësh 160 milionë nga taksa e ndërtimit në infrastrukturë?! Nëse është një biznes kaq i fortë (një nga vitrinat e biznesit në botë, i cili ku ka shkuar, ka ndryshuar faqen e ekonomisë së atij vendi, në fakt nuk më rezulton kështu për Zagrebin dhe Kroacinë), përse ka nevojë dhe ka kërkuar që 160 milionë nga taksat, të cilat janë paratë e shqiptarëve, t'ia falim? Çfarë qenka ky njeri, i cili mund të vijë me të gjitha gamilet e veta, me qilimin fluturues, që ardhka në Shqipëri dhe ti i fal 60 milionë nga ndërtimi që do të kryhet, të cilat duhej të shkonin për strehimin social, për të pastrehët e Durrësit që ke miratuar me ligj në vitin 2019? Tani kush është bujari në këtë mes? Kush është bamirësi?

E kuptoj shumë mirë që ky vend ka nevojë për financa dhe për emër, por nuk mund të bëhesh avokati mbrojtës i Mohamed Alabbar. E ke për detyrim kushtetues ligjor, moral dhe deri këtu, se të tjerat e di që nuk i di dhe nuk i njeh, të jesh mbrojtës i pasurisë së shqiptarëve. Ti ke ndërruar rolet dhe je bërë avokati i tyre. Na takon neve ta mbrojmë, i takon kësaj opozite; në fakt, u takon të gjithë atyre deputetëve që kanë ikur, edhe zonjës ministre që sapo erdhi, sepse një gjë është e vërtetë, me votat që kanë, sigurisht që do ta votojnë. Këtë e dija që para 2 javësh, që kur erdhi me procedurë të përshpejtuar,

ashtu hajdutëshe, vjedhurazi, që të mos e merrte vesh njeri, pa asnjë lloj dokumenti, në errësirë. Pretendohet se për një vit e ca kanë negociuar me njëri-tjetrin, por askush nuk dinte asgjë deri para 2 javësh. E kuptoj, i keni votat dhe do ta votoni.

Në fakt, dua të them edhe diçka tjetër: si ka mundësi, ky është i vetmi investitor strategjik (mund të jetë një emër i nderuar, por nuk më intereson, sepse ajo që më intereson është interesi i shqiptarëve dhe pasuria e tyre), nga 34 që na keni paraqitur deri tani, ndërkohë që 33 të tjerëve, që janë miqtë dhe klientët tuaj, nuk ua keni mbuluar me ligj klientelizmin e tutelën që po u bëni, duke u dhënë pasuritë e shqiptarëve? Jo, nuk keni arritur deri aty. Këtij të pasurit, i cili, si i tillë, nuk duhej të kishte nevojë fare për të pasur më shumë privilegje se oligarkët shqiptarë, ne i japim edhe një mbulesë ligjore.

Arsyeja është e thjeshtë: të shpërndajë përgjegjësinë penale edhe me ju të tjerët, me të gjithë ata që do ta votojnë këtë ligj, se ndryshe nuk ka si të shpjegohet ardhja e një investitori me qilim fluturës, vetëm me 80 milionë euro, për 818 mijë metra katrorë, që është vlerësuar 730 milionë, të cilat ne po ia japim atij. E ndërkohë sa fitojmë ne? Sa fitojnë shqiptarët? Në rastin më të mirë 280 milionë euro, nga një pasuri që është vlerësuar sot 730 milionë. Pra, pas 20 vjetësh, jallah po të marrim 280 milionë euro! Kjo është të përdorësh portin e Durrësit dhe Shqipërinë si mall pa zot. Vjen këtu me patosin e madh patriotik, duke kënduar bejte të dikurshme për t'u shitur shqiptarëve aktin e madh që po bën për të mirën e Shqipërisë, për ta zhvilluar, siç bëri me inceneratorët.

Plehrat ishin, plehrat janë; paratë ishin, por paratë nuk janë. Pra, siç ka ndodhur deri diku me inceneratorët, duhet të ndodhë edhe me këtë aferë: disa njerëz duhet t'i nënshtrohen drejtësisë, të paktën deri tani. Thirrja ime është për ju, deputetë të maxhorancës, që me sy të zgurdulluar merrni kartonin thjesht për të votuar, se nuk e dini çfarë po votoni, jeni të detyruar të votoni. Kujdes, jo vetëm fajësimi publik, turpi moral, por edhe përgjegjësia penale do të bjerë mbi ju, nëse nuk votoni ashtu siç duhet, në interes të zgjedhësve tuaj dhe të pasurisë publike! Pra, disa pyetje të thjeshta duhet t'i ngrejë kushdo. Garë, more, garë! Pse ju mendoni se ne nuk duam që ky vend të zhvillohet? Pse mendoni që ne jemi të qetë dhe kemi nostalgji për oksidentin, që të shohim portin në mes të Durrësit? Jo, aspak, por edhe ta shesim për 2 pare, sepse dëshiron ky, kjo është e pafalshme. Këtu nuk na keni me vete; kurrë nuk do të na keni me vete.

Së dyti, kush është ky që na ka ardhur dhe Durrësit, durrsakëve dhe shqiptarëve u paska mbirë fati në derë?! Është Mohamed Alabbar? E çfarë pastaj?! Ndërkohë, dokumentet që me zor erdhën, sepse i mbanin të fshehura, tregonin një gjë shumë të thjeshtë: statusi i investitorit strategjik, i dhënë nga ky, i

është dhënë një shoqërie, e cila me dokumente ishte e regjistruar në ishujt Kajman. E pranojnë edhe vetë. E ku?! Në Shqipëri, e cila tregohet me gisht, sepse është vendi që është vendosur në listën gri dhe shumë shpejt do të bëhet e zezë për pastrimin e parave. Pra, i jepet me lehtësinë më të madhe, me arrogancën më të madhe, me shpërfilljen më të madhe për ligjet, për Kushtetutën dhe për detyrimet që Bashkimi Europian i ka vendosur këtij vendi. Jo, nuk ka rëndësi, le të jesh i regjistruar në offshore; askush të mos e dijë se kush është pas kësaj pune, se me plaçkën e shqiptarëve mund të bësh çfarë të duash, mund të falen 818 mijë metra katrorë dhe të bëhesh investitor strategjik.

Në fakt, ka një gjë tjetër pas kësaj historie, ky investitori i madh, të cilit ky kishte një vit që i lutej dhe i përgjerohej, vjen e sjell, të paktën sipas fjalës së tij në këto dokumente, vetëm shumë mizerabël prej 160 milionësh, ku 80 milionë i ka në xhepin e djathtë dhe 80 të tjerat do t'i marrë me kredi; kaq; asgjë më shumë. Po pjesa tjetër?! Po 1,9 miliardë euro, aq sa është parashikuar investimi në projektin që tregoi këtu me fotografi, nga do të dalin? Kush do t'i sjellë? Kush i ka? Asgjë nuk thuhet në këtë marrëveshje. Pyes ministren e Transportit, ka zero përgjigje; pyes drejtorin e portit, ka zero përgjigje. Asnjë nuk kthen përgjigje. Do të vijnë nga burime të treta. Cilat janë këto burime? A mos janë këto burime nga ata, që kanë ndërtuar numrin maksimal të ndërtimeve dhe gradaçelëve në Tiranë? Burim tjetër nuk ka dhe nuk thuhet askush? A mos janë këto mjeti për të infiltruar dhe për të penetruar në Shqipëri, e cila është e shkallmuar nga të gjitha anët, ku hyn derri me dosën bashkë, paratë e krimit? Alternativë tjetër nuk ka.

Janë 1,9 miliardë euro të projektuara për t'u investuar në Durrës, që do të vijnë vetëm nga paraja e krimit, sepse nuk kanë nga vijnë. Në fakt, eksperimenti është bërë në Tiranë, e cila është lavatriçja e Ballkanit. Sipas raporteve ndërkombëtare, në Tiranë janë pastruar 1,6 miliardë euro me kulla të larta, me kate me leje dhe pa leje, me ndërtime kudo, pra pastrim parash. Ndërkohë, në një aferë pastrimi paraje, siç është kjo e Durrësit, që është 10-fish më e madhe, mendoni se çfarë do të ndodhë... Si mund të gëzohesh që në këtë vend po vjen paraja e krimit, ndërkohë që bashkë me të vjen edhe shkatërrimi i ekonomisë, shkatërrimi i shoqërisë dhe i shtetit; refuzimi i këtij vendi nga Bashkimi Europian për sot dhe për shumë vjet? Ky është rreziku i madh. Humbasim pasurinë publike; na e shet pasurinë publike dhe e hedh Shqipërinë në honet më të errëta të botës së Perëndimit. Pra, kjo është e dyta.

Jo më larg se dje u mor një sinjal nga Bashkimi Europian, ku 28 milionë eurot, të cilat duhej t'i jepte për portin e Durrësit, i tërhoqi mbrapsht. Pse duhet të vëmë minimumin, atë çfarë kemi bërë edhe më përpara, por t'u kërkojmë edhe atyre: a është kjo një procedurë, një biznes, në të mirë të shqiptarëve, në respektim të Kushtetutës; patjetër, le të sjellë para për shqiptarët, por jo paranë e krimit; të rrisë

mirëqenien e shqiptarëve, që ata të mos ikin? Vetëm kjo është mënyra se si mund të bëhet biznes i ndershëm dhe i shëndetshëm në këtë vend. E mira është që të flasim me fakte të thjeshta, pa patos, pa emfazë, pa ngjyrimë. 818 mijë metra katrorë për 500 euro, ishte përgjigjja që dhanë në komision përfaqësuesit e ministrisë, pra bëjnë 400 milionë euro, të cilat do t'i japin.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë, e pranuan edhe vetë, është 160 milionë; vlera e ndërtimeve, që duhet t'u shpërndahet durrsakëve, është 60 milionë. Bëjini vetë llogaritë sa euro do të japin në total. Sa fitojmë? Sipas letrave, në rastin më të mirë fitojmë 280 milionë euro. Çfarë llogarie është kjo? Çfarë leverdie ekonomike është kjo, që jep 7 dhe merr 2?! Si mund ta bësh këtë gjë?! Çfarë emri tjetër ka kjo, përveçse një vjedhje e pastër dhe asgjë më shumë. Këto janë fakte të pranuar nga vetë qeveria. Si mund të pranohet kjo?! Në rastin më të thjeshtë, nëse do të ishte vërtet një biznesmen i ndershëm, që do të vinte këtu edhe për të parë interesin e tij dhe nuk do të vinte këtu për të na bërë nder ne, do të duhej, së paku, për interesin tonë të kërkonim atë që çdo shqiptar do ta kërkonte për pronën e tij. Sa sipërfaqe do të jepet? Sa është sipërfaqja që do të ndërtohet?

Minimumi janë 1 milion e 200 mijë metra katrorë, që do të ndërtohen në Durrës dhe, sipas një llogarie, që mund ta bëjë kushdo që ka pasur një pronë në Tiranë, në Durrës, në Shkodër, në Vlorë apo kudo, e di që ka një përqindje, dhe unë po marr përqindjen që këta kanë vendosur, e cila është 30%. Kjo do të thotë se për 400 mijë metra katrorë ndërtim, shumëzuar për 1500 euro për metër/katrorë, aq sa është vlera në Durrës, nuk po marr shifrat që janë në Tiranë, shtetit shqiptar duhet t'i shkojnë në tavolinë jo pak, por 650 milionë euro. Llogarinë më të thjeshtë duhej ta bënte gjithkush. Ky është i kënaqur me shifrën prej 280 milionë eurosh dhe jallah po të realizohet.

Ja, pra, kjo është vjedhje; ky është shpërdorim; kjo është ta përdorësh dhe ta shpërdorësh pronën si mallin e babait. Ky është preludi i asaj, e cila do të jetë afera më e madhe korruptive, hajdutëria më e madhe që po u ndodh shqiptarëve dhe Shqipërisë, por nuk ka mbaruar këtu. Unë jam dakord dhe është e vërtetë që ai port është i vjetër, sepse është që në kohën e Adem Rekës dhe nuk mund të kemi një port të tillë në mes të Durrësit, i cili është ndërtuar që nga koha e komunizmit. Jam shumë dakord, por pyetja është: po gjithë ato shërbime, që jepen aty, ku do të shkojnë?! Në cilin port të ri?! Me çfarë parash do ta ndërtoni, se duhet ndërtuar ai port?

Ne nuk kemi luksin që të bëjmë një port turistik, ku jallah nëse vijnë apo jo jahtet e turistëve në këtë vend, që të heqim dorë nga një port, i cili është nyja ekonomike më e rëndësishme e Durrësit, e Shqipërisë, e Kosovës, e Maqedonisë e më gjerë se kaq. Si ka mundësi që ka zero projekt?! Kam pyetur

ministrat se sa para janë parashikuar për ta zhvendosur portin e vjetër të Durrësit, ashtu siç është zhele, për ta çuar në një vend tjetër? Ngrenë supet, duke thënë se nuk dinë gjë; dhanë vetëm përgjigjen se është bërë një projekt në letra nga një kompani holandeze, e cila vetëm për të bërë projektin, për të bërë studimin, ka marrë 10 milionë euro. Sipas atyre që marrin vesh nga kjo punë, kur kjo shifër në minimumin e saj është 10 milionë, vetëm buxheti për ta zhvendosur atë port zhele, atë port të mbaruar, për ta çuar në një vend tjetër duhet të jetë jo më pak se 1 miliard.

Pyetja tjetër është: kush i paguan këto para?! Pse të mos i paguajë ky “Aladini” me qilim fluturues? Pse të mos i paguajë ai, se i pasur është, se portin po e merr, portin e jahteve po e bën dhe do të ndërtojë në Durrës pallate pa fund? Janë 1 milion e 200 mijë metra katrorë në minimum, se në maksimum kanë parashikuar deri në 2 milionë metra katrorë ndërtim; po ta shumëzojmë me 1500 euro, bëjini vetë llogaritë. Pse të mos e bëjë edhe këtë gjë? Ne do të ishim dakord, madje shumë dakord. Ka nevojë për një port të ri të zhvendosur diku tjetër, jo aty ku është, në mënyrë që të ndodhë volumi i shkëmbimit të mallrave dhe të njerëzve.

Ta kemi edhe portin turistik, por, mbi të gjitha, duhet të kemi portin e mallrave. Le të ndodhë kjo gjë, por mos i vini një kryq të madh portit ekzistues, ashtu siç është ai port zhele, dhe të gjithë impulsit ekonomik, sepse kështu i vini një kryq të madh vlerës gjeostrategjike që ka ai port zhele, për të cilin nuk kam fare nostalgji, të them të drejtën, por ka vlera të tjera, vlerën historike, vlerën ekonomike, vlerën gjeostrategjike, të cilën e kemi vetëm ne dhe duhet ta ruajmë. A duhet ta zhvendosim?! Pse jo, por, meqenëse po vjen një me qilim fluturues, me gamile plot me verdhushka, pse të mos e bëjë ai? Kjo është dashamirësi për Shqipërisë, nëse është dashamirësi, ndryshe është vetëm një aferë e pastër hajdutërie, që kërkohet të mbulohet thjesht me atë patosin patriotik, që erdhi ky dhe po bën këtë gjë.

Çfarë po bën? Erdhi ky e po vjedh, siç ka vjedhur me inceneratorët, pa u skuqur dhe pa u zverdhur! Ka gjetur disa njerëz, të cilët votojnë nën frikë, nën terror, por dua të them edhe gjënë tjetër se ai ka parashikuar edhe këtë pjesë. Janë kaq shumë para të zeza në xhiro: 1,9 miliardë, të cilat do të vijnë dhe do të thithen nga kjo gropë e zezë, që do të mbyllin gojën e shumë deputetëve këtej, që do të mbyllin gojën e shumë bizneseve; do të jenë para kërmë që do të tërheqin të gjithë oligarkët e këtij, që do të tërheqin krimin dhe pasuritë e tij të bëra këtu apo jashtë. Kaq e frikshme është kjo që po ndodh, ndaj ai vjen këtu, merr plaçkat e ikën dhe thotë plot arrogancë që do ta votojnë. Ne e dimë që do ta votoni, se nuk ka ndonjë çudi.

Turpi 3 ditë zgjat, me një biftek të Nusretit dhe mbaron puna, por dëmi do t'i bëhet këtij vendi dhe jo thjesht ekonomisë; do të shndërrohet në një ekonomi të zezë, ku krimi do të vendosë përfundimisht flamurin e tij, ku shteti do të bjerë më shumë se sa ka rënë, ku ligji nuk do të ekzistojë, kur medias do t'i mbyllet goja, siç ndodhi me inceneratorët. Në fakt, ne duhet ta kemi edhe kurajën ta themi e të mos jemi si disa njerëz, të cilët në njëfarë mënyre presin se mos marrin ndonjë gjë nga këta 2,1 miliardë. Kjo është kuraja, sidomos në parlament, të cilën çdokush duhet ta nxjerrë në pah. Këtu vendoset dhe vendoset sot.

E di që tundimi është i madh, presioni është i madh, se janë 2,1 miliardë; e di që shumë oligarkë të këtij kanë ndarë llokat; e di që shumë banda të krimit janë duke i nxjerrë nga poshtë dyshekëve dhe duke i futur nën tokë paratë e krimit për të investuar në portin e Durrësit. 1,9 miliardë është shumë e madhe dhe ka për të gjithë. Ky garanton vetëm një gjë: të pastrojë paratë. Kjo është ajo çfarë po ndodh. Përfundimisht, shteti, ligji dhe demokracia janë vetëm një mirazh si në Lindjen e largët, se me kaq para ky blen gjithçka; krimi blen gjithçka; oligarkia blen gjithçka dhe ky është fundi i shtetit, fundi i ligjit, fundi demokracisë dhe fundi i ëndrrës së madhe për të shkuar në Europë. Jo, more, është thjesht dhe vetëm një parajsë e krimit dhe pastrimit të parave. Kështu do të shndërrohet ky vend.

Kush ka sy dhe kush ka mendje, duhet ta shikojë dhe duhet ta kuptojë sot, se ndoshta kjo është njolla më e madhe për të gjithë ata, të cilët kanë sot një mundësi, qoftë edhe të vogël, për ta ndaluar, por duhet ta shfaqin dhe jo të ulin kokën e të thonë se ishin të detyruar nga ai, nesër, pasnesër dhe gjatë gjithë jetës së tyre. A do të jeni apo jo nesër në politikë, kjo nuk ka rëndësi, por nesër do të mbaheni mend vetëm si njerëzit, të cilët votuat me sytë mbyllur, me kokën ulur dhe me shpresën se mos ndoshta do t'u hidhet ndonjë thërrime nga këto 2,1 miliardë. Ndërkohë, kjo është fatkeqësia më e madhe që po i ndodh Shqipërisë. Ç'të mirë ka sjellë ky njeri? Solli ndonjë të mirë ky me kanabisin? Solli ndonjë të mirë ky me inceneratorët? Solli ndonjë të mirë ky me investitorët strategjikë? Asgjë. Keq e më keq gjithmonë.

Kjo e sotmja është tamam qershia mbi tortë. Ky është detyrimi ynë. Ky është detyrimi i kësaj pjese të opozitës, dhe sot mund të dukemi edhe si të çuditshëm: si ka mundësi që disa nga opozita ngulin këmbë me fakte dhe prova që kjo të mos ndodhë? Çfarë kanë këta? Shumë bëjnë pyetjen: çfarë kanë këta që dalin kundër? Ky e tha: "Përveç përbetimeve që bëjnë disa të tjerë për luftë të madhe, të paepur patriotike për të ndërprerë këtë aferë korruptive, kur vjen momenti për të folur dhe për të nxjerrë dokumente, heshtin, mbyllin gojën, sikur kanë punë të tjera; nuk janë më këtu në parlament". Jo, ky është momenti. E dini nga vjen kjo? Vjen nga fakti që kjo pjesë këtu nuk është e kapur, i reziston tundimit, ka moral.

Në fakt, kjo është ajo çfarë ka nevojë sot Shqipëria, ky vend, për të dalë nga kjo shtjellë, nga kjo spirale 30-vjeçare, ku vjen njëri këtu dhe bën përgjërmin më të madh për ndihmën, për të mirën, për dashamirësinë, për bujarinë, për zemërgjerësinë e madhe që ka, për xhanin që i digjet për shqiptarët, duke u siguruar ndihmë kaq të madhe prej 2,1 miliardësh nga Lindja e largët në mes të Adriatikut. Hiç, asgjë nuk është. Është teatri hipokrit i vjedhjes më të madhe që po ndodh. Kaq e thjeshtë është. Së pari, ky është detyrimi ynë historik: t'ia bëjmë me dije publikut, siç edhe ia bëmë, e mbani mend që dy javë më parë askush nuk dinte asgjë. Zero.

Nuk patëm asnjë paragjykim, sepse pritëm sa të vinin dokumentet, sa të dilnin faktet dhe sot nuk ka shqiptar të painformuar; nuk ka gazetar të mos dijë çfarë po ndodh. Kjo është merita jonë. E vogël, por është jona. Jo vetëm kaq, sepse nuk do të ndalemi këtu, aq sa jemi, me këtë lloj qëndrimi. Prandaj i kërkuam edhe Bashkimit European të shprehej nëse kjo është një marrëveshje që shkel Kushtetutën e shqiptarëve dhe të europianëve bashkë, marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit? E thjeshtë. Le ta shprehin ata. Një gjë është e sigurt: ata duan të mirën tonë. Brukseli dëshiron të mirën tonë. A është kjo një mundësi që të jetësojë planin ogurzi të amnistisë fiskale? Sa bukur!

Bëjmë një amnisti fiskale, i mbledhim paratë e zeza kudo ku janë, i pastrojmë. Si do t'i pastrojmë? Si të krijojmë një projekt masiv ndërtimesh, siç do të ndodhë në Durrës, dhe paraja del e pastër pasi hyn sterrë e zezë nga krimi? Si do ta bëjmë këtë? Nëpërmjet pasaportave të arta. Shesim pasuri dhe ata na blejnë shtetësi. Nuk ka turp më të madh se kaq! Nuk ka mungesë cipe më të madhe! Kjo është mungesë patriotizmi: të shesësh Shqipërinë në duart e krimit. T'ia japësh këtë vend duarve të krimit, që ta përdorin si strehë për të gjitha paudhësitë e kësaj bote, ta bëjnë koshin më të madh të plehrave dhe të mbeturinave në botë. Si tha? Do të pastronte Portin e Durrësit nga ato fotografitë? Në fakt, po e kthen në koshin më të madh të mbeturinave të krimit dhe të parasë së zezë në mes të Europës. Kaq e thjeshtë është.

I trajton shqiptarët si indigjenët kur zbuloheshin dikur, që i gënjente me pasqyra dhe mezi i ka. Ja, ky, patrioti i madh, i kënduari i madh. Dakord, por nuk e kuptova pse kishte dihatje?! Ç'është ajo dihatje? I vjen nga pasioni apo nga ankthi i vjedhjes? Duhet të jetë e dyta: ankthi i vjedhjes. Ka një gjë të madhe, i ka ardhur, i ka arritur me pazaret, do ta mbajë aty vetë, askush të mos futet, ta bëjë shpejt e shpejt, me procedurë të përshpejtuar, natën, pa asnjë negociatë transparente. 2,1 miliardë. Ej, 2,1 miliardë. Shumë para e madhe. I sëmurë, siç është pas kësaj manie, e shtyn, ndaj edhe ka dihatje. Janë simptomat e qarta të hajdutit. Mori leckën dhe iku. Do ta votojë! E di që do ta votoni, nuk kam asnjë dyshim, por ne do të



bëjmë detyrën tonë. Sapo ju ta miratoni, do ta çojmë në Gjykatën Kushtetuese. Ky është detyrimi i opozitës.

Në fakt, është detyrim minimal, sepse kemi edhe një detyrim tjetër më të madh se kaq, t'u bëjmë dritë shqiptarëve, që ta kuptojnë çfarë po ndodh, të dalin nga kllapia ku ky beson se i sugjestionoi me leximet dhe këndimet e para gjysmë ore. Të kuptojnë se po u ikën pasuria e tyre; nuk është e këtij, nuk është jona, është e shqiptarëve, e të gjithë shqiptarëve. Të gjithë shqiptarët duhet të bëjnë minimalisht atë që bënë kroatët në Zagreb, me të njëjtin Mohamet Alabbar, i cili e kuptoi se kishte bërë gabim dhe kërkoi falje. Në fakt, bëri mirë. Kështu ndodh në një vend të civilizuar, i bëhet thirrje arsyes, ndërgjegjes dhe kur arroganca, verbëria dhe grykësia fitojnë, duhet të dalin shqiptarët për të mbrojtur pronën e tyre. Shqiptarë, duhet të mbron pronën tuaj! Mos lejoni t'ju vidhet! Është juaja. Po ju merret. Po ia fal, duke mbushur vetëm xhepat e tij dhe të oligarkëve të krimit, siç ka bërë gjithmonë.

Detyrimi ynë është të bëjmë dritë, ta bëjmë të qartë për këdo, të bëjmë transparencë. Ky është detyrimi ynë dhe po bëjmë shumë mirë. Nuk mbaron këtu. Një gjë është e sigurt edhe për tradhtarët, që kjo e sotmja është vetëm fillimi. Tringëllimën e prangave të dy javëve më parë, që bënë të nxirrte atë përrua psikik, duhet ta keni parasysh të gjithë ju. Ne kemi vetëm detyrimin t'ju bëjmë me dije, sepse ndoshta në të gjithë këtë marrëzi të madhe, ku besoni se me vota mund të vidhni Durrësin, mund të vidhni zgjedhjet, mund të vidhni buxhete, ndoshta besoni se me këtë mund të vidhni edhe vullnetin e shqiptarëve; mund t'ia keni arritur deri në një farë mënyre, por kujdes, sepse kur orteku të dalë, kur të ngrihet, nuk do të ketë më poezi, vjersha e bejte që mund t'i këndoje dikush nga foltorja për t'ju sugjestionuar. Jo. Kujdes nga ajo ditë!

Ajo ditë jo vetëm që duhet të vijë një orë e më parë nëse vazhdoni me këtë marrëzi, por kini parasysh çfarë dëmi të madh do t'i krijoni këtij vendi. Ftoheni mendjen dhe shikoni edhe në këtë rast interesin tuaj, sepse, siç janë sot ende në qeli kolegët tuaj dhe do të vazhdojnë të jenë, me sforco të madhe të kësaj drejtësie të re, e cila vetëm belbëzon sot, por nesër mund t'i vijë zëri, dhe radha do të jetë juaja. Më pas, thirrja e vetme do të jetë: të shpëtojë kush të mundet. Ne kemi detyrimin vetëm t'ju paralajmërojmë për këtë gjë. Nuk e bëj se kam ndonjë keqardhje për ju, por sepse bashkë me të uroj të shpëtohet interesi, prona dhe pasuria e shqiptarëve. Kjo më intereson. Kjo na intereson ne, asgjë tjetër. Ndaj i bëj këto thirrje. E di që do të jenë si zë në shkretëtirë, meqë ra fjala, por dikush po i dëgjon me qetësi, po mendon, po reflekton, dhe do të na gjykojë ne dhe ju. Kjo që po ndodh me portin e Durrësit është e qartë, e thjeshtë dhe e kuptueshme për këdo.

Në fund, shqiptarët do të na gjykojnë, do të na vlerësojnë. Ne bëmë tonën dhe do të vazhdojmë edhe në të ardhmen për t'i vënë fre, për t'i vendosur bllok kësaj marrëzie të madhe, që po na e shet ky me lajlule orientale, por nuk mjafton të jemi vetëm ne, kjo është thirrje për të gjithë shqiptarët, është e nevojshme, e domosdoshme sot për të gjithë shqiptarët e ndershëm, pa dallim profili politik, ata që janë njerëzit e djersës, të gjakut, të punës, të nderit, që t'i dalin përballë sot dhe t'i bëhen krah kauzës, jo neve, jo këtyre deputetëve, por kauzës, interesit të tyre. Është e mundshme.

Ky vend nuk mund të vazhdojë më si 30 vjet, hidh e prit, të bëjë zhurmë nga njëra anë, të bëjë zhurmë nga ana tjetër dhe këtu gjithçka të vidhet, të abuzohet, të shpërdorohet dhe shqiptarët të rrinë me gisht në gojë; madje, para disa kohësh, sepse tashmë janë duke ikur natën. Ky është një detyrim që të gjithë bashkë ia kemi këtij vendi. Nuk jemi pak, por jemi shumë. Duhet të dalim nga letargjia, nga kllapia ku na kanë vendosur në këto 30 vjet për të bërë këtë gjë, sepse tej kësaj nuk ngelet asgjë; do të ngelet thjesht dhe vetëm merak: pse nuk e bëmë atëherë kur duhej. Ky moment është tani. Të paktën për portin e Durrësit. Të paktën kësaj afere t'i vendosim kufirin te thana. Këtë mund ta bëjnë vetëm shqiptarët. Faleminderit!